



Prishtinë: 20.08.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1026\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1805\_05\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **14.06.2018**.

### në seancën e mbajtur më datë 20.08.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M.S. nga Besiana me shifër të konsumatorit DPR – 90073512 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1805\_05\_18 i datës 15.05.2018.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se njehsorët elektrik në lagjen e tij janë të vendosur në shtyllë dhe jo në shtëpi. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se posedon një dhomë, një dritë, një televizor, një bojler të cilën e ndez prej orës 12 të natës dhe se pagesa sillet maksimumi 45€, ndërsa në bazë të disa shtëpive tjera të cilët kanë edhe më shumë pajisje fatura sillet 15 deri 20 €. Konsumatori ka theksuar se ka marrë disa elektricitetë të cilët kanë thënë se diçka nuk është në rregull. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kërkon që të has në mirëkuptim pasi që është i papunë, i sëmurë me fëmijë të vegjë nuk merr pension edhe pse është familje e dëshmorëve.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se konsumatori posedon vetëm disa pajisje të cilat nuk mund të bëjnë atë shpenzim të faturuar nga KESCO, Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht procesverbalit të inspektimit ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në procesverbalin e inspektimit të pikës matëse nr.1176521 e datës



10.11.2015 përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të muajit 10/2015 dhe 01/2015, pra sipas kësaj vërtetohet se shpenzimi në njehsor është evident. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, dhe se në asnjë muaj nuk vërehet se kemi të bëjmë me lexim jo të rregullt. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike mes njehsorin elektrik nr.64099201 krahasuar me shpenzimet e regjistruara në njehsorin paraprak konstatohet se konsumatori ka ndryshim të shpenzimit të energjisë, por jo ndonjë ndryshim të madh të shpenzimit e cila do të duhej të veçej. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE ka bërë analizimin e shpenzimit të përgjithshëm të energjisë së elektrike të këtij konsumatori dhe ka vërejtur se për periudhën 06/2013 deri në periudhën 05/2015 me njehsorin elektrik e vjetër elektrik mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë 471.08 kWh/muaj, ndërsa me njehsorin kontestues nr.64099201 prej periudhës 06/2015 deri në periudhën 09/2017 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është 669.79 kWh/muaj. Pra nga kjo shihet qartë se konsumatori nuk ka ndonjë ndryshim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike mes njehsorëve.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit të njehsorit të vjetër dhe njehsorit të ri, ka vërejtur se kemi dallim të shpenzimit në kohën e shfrytëzimit të tarifave, ku nga analiza vërehet se konsumatori me njehsorin e vjetër për periudhën e lartcekur ka shpenzuar mesatarisht 3% në tarifën e lartë, ndërsa 97% në tarifën e ulët. Ndërsa me njehsorin e ri elektrik konsumatori mesatarisht në tarifën e lartë ka shpenzuar 69%, ndërsa 31% në tarifën e ulët. Bazuar në strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE për konsumatorët e rregulluar tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00h deri në ora 22:00h gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00h deri në ora 23:00h gjatë sezonit të ulët. Po ashtu njehsori i ri digjital ka të integruar numëruesin tarifor i cili bënë rregullimin e kohës tarifore të shfrytëzimit të energjisë elektrike bazuar në strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE. Pra, Bordi i ZRRE thekson se konsumatori nuk ka ndryshim të madh në shpenzimin e energjisë mes njehsorëve, por që ka ndryshim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike në kohën e shfrytëzimit të saj.

Sa i përket pikës së ankesës së konsumatorit se ka marr disa elektricistë dhe se sipas tyre është konstatuar se diçka nuk është në rregull, Bordi i ZRRE-së thekson se në procesverbalin e inspektimit të KEDS-it nr.64099201 i datës 10.11.2015 nuk është konstatuar se kemi ndonjë defekt të pikës matëse, si dhe informon konsumatorin se sipas dispozitave ligjore Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji personat e autorizuar për të inspektuar pikën matëse janë punëtorët e autorizuar të KEDS-it. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS/KESCO ka respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, pasi që ka bërë faturim të rregullt dhe të saktë të pikës matëse.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit M.S.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së